



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:115209

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05763030

P.nr.378/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Donjeta Mulla, në çështjen penale kundër të pandehurit N. G nga fshati V Komuna Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Sulmi” nga neni 184 par. 3 nën par. 3.1 lidhur 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.725/2023, e datës 19.05.2023, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar jopublik me datë 02.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Lumturije Hoxha dhe të pandehurit N. G, me datë 03.04.2024 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

N.G i lindur më datë 23.03.1980, në Pejë, me banim në fshatin V K. Pejë, nga babai I dhe nëna F e gjinisë G, i, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, i njohur me numër personal, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, me tel., mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt., rreth orës, në fshatin V, Reoni .., K. Pejë, i pandehuri N.G me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarës Y.Sh dhe të miturës Xh. A, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje mes të pandehurit dhe dy të dëmtuarave, i pandehuri deri sa ishte me veturën e tij në rrugë, ku pasi i vëren të dëmtuarat, e ndalon veturën afër tyre, del nga vetura, fillimisht fjaloset me to dhe pastaj i sulmon fizikisht të dyja, ashtu që së pari e kap për fyti dhe e godet me shuplakë fytyrës të dëmtuarën Y, e pastaj e kap për flokësh dhe e godet shuplakë në fytyrë të miturës Xh. A, ku si pasojë e kësaj të dëmtuarat ndjenë dhimbje në fytyrë me çka nënkupton ankesa subjektive, pa lëndime trupore,

- me çka ka kryer vepër penale „Sulmi” nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 184 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, nenit 364,365, 452 par.4, nenit 462 par.2 të KPP-së, gjykata të pandehurin N G e:

G J Y K O N

- I.** Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë**, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- II.** I pandehuri lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.
- III.** Palët e dëmtuara Y Sh nga fshati V I, komuna Pejë, dhe Xh A nga fshati V rr. N. Z, komuna Pejë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 19.05.2023 ka ngrit aktakuzë nën shenjë PP/II.nr.725/2023, kundër të pandehurit N.G nga fsh. V, Komuna Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „ Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 02.04.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Lumturije Hoxha dhe të pandehurit N G.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurit në të drejtat e tyre.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se i pandehuri e kanë kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i udhëzuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri N. G lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehurit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë, i pandehuri e ka bërë në mënyrë vullnetare me vetëdije të plotë, pa presion dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e tij është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështetet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit Besim Sahitaj #4736 me nr. 2023-DA-0432 i dt. 02.04.2023, Deklarata e të

dëmtuarës Y.Sh e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 02.04.2023, Deklarata e të dëmtuarës Xh.A e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 11.04.2023, Deklarata e të dëshmitares M.G e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 11.04.2023, Deklarata e të pandehurit N. G e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 11.04.2023, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Prokurori i shtetit, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës, që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese dënimet e mëparshme eventuale.

I pandehuri i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë dhe gjendjen e dobët ekonomike.

Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit vlerësoj se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të pandehurit, pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, padyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit N. G , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjykata gjatë procedurës penale nuk gjeti rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata, për vendimin mbi dënim ka vendosur pasi që i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, ka vlerësuar faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, gjenden dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata morri parasysh se vepra është kryer ndaj viktimës së ndjeshme të miturës Xh. A

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 452 par. 4 të KPPRK-së, pasi gjatë procedurës nga ana e të pandehurit është prezantuar kartela e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Pejë me numër të regjistrimit 11834, kartelë e evidentuar në emër të të pandehurit N G, e vlefshme deri më datë 01.06.2024, gjë që vërteton se i pandehuri është përfitues i ndihmës sociale, prandaj gjykata vlerëson se me ngarkimin e shpenzimeve të procedurës të pandehurës do të rrezikohet seriozisht gjendja materiale e tij po ashtu edhe familjes së tij.

Konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata të dëmtuarat Y. Sh dhe Xh. A me përfaqësuesin e saj ligjor, i udhëzon në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.378/2023, me datë 02.05.2024

Zyrtare ligjore

Gjyqtare e vetme gjykuese

Donjeta Mulla

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.